



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË ISHTETIT

*Departamenti i Auditimit të Buchatit Qendror, Administratori i Lartë Publik, Menaxhimi i
Financiar dhe Auditimit të Brendshëm*

Mbi Auditimin në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë

Kontrolli i Lartë i Shtetit përfundoi auditimin në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH), me temë “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar” për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2013. Raporti Përfundimtar si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së të datës 05.09.2014.

Në përfundim të auditimit bazuar në nivelin e konstatimeve dhe gjetjeve të grupit të auditimit janë dhënë rekomandime në funksion të përmirësimit të punës së kësaj drejtorie sidomos në drejtim të evidentimit të nevojave të personave që priten të përfitojnë nga skemat e pensioneve por edhe të mirëadministrimit të fondeve në dispozicion.

Duke qënë se pjesën e përmirësimeve ligjore që do të ndihmonin në përmirësimin e deficitit të skemës së sigurimeve i kishim trajtuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, fokusi i këtij auditimi ishte puna apo aktiviteti operativ i specialistëve që mbullojnë me shërbim rajonin më të madh atë të Tiranës, të cilat bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i janë përcjellë subjektit.

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi me zgjedhje i ushtruar në dokumentacionin që ndodhet në dosjet e pensioneve të lidhura sipas Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezultoi se, ka pasaktësi në llogaritjet e masës së përfitimeve, të cilat kanë sjellë përfitime të padrejta në shumën **6,8 milionë lekë**, për këtë kemi **rekomanduar**:

- Të bëhet rishqyrtimi i dosjeve për përfituesit e kësaj kategorie dhe të saktësohet niveli i pensioneve për këtë kategori për të gjithë personat që kanë adresuar ankesa lidhur me këtë lloj pensioni. Gjykojmë se, pavarësisht kufizimeve që mund të kenë në kapacitete, ballafaqimi me ankimesin për të qartësuar çdo llogaritje do të shërbente rritjet së besueshmërisë për trajtim profesional të ankesës, sqarimit të saj dhe eliminimit të adresimeve të tyre drejt institucioneve të tjera

-Rishqyrtimi i përfitimit të shoqërohet me kontabilizimin, shpalljen debitorë/kreditorë e përfituesve si dhe në rastin e përfitimeve të padrejta të kërkohet arkëtimi i shumës së dëmit financiar, sipas kërkesave të nenit 62, pika 3 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Menjëherë

2. Nga auditimi me zgjedhje të dosjeve të pensionistëve debitor për Sigurimet Shoqërore, për vitin 2012, rezultoi se, nga Dega e Financës nuk ishte ndaluar shuma 50 % e masës së pensionit për çdo përfitues, por 25% dhe 30%. Veprim që kanë sjellë një efekt negativ financiar në shumën **1 milionë lekë, rekomandojmë:**

- Për përfituesit debitor, nga Dega e Financës të fillojnë ndalesat në masën 50% të pensionit për çdo përfitues, sipas kërkesave të nenit 62, pika 3 e Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Menjëherë

3. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për Prokurimin Publik, për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor në DRSSH, kemi **rekomanduar:**

- Titullari i Autoritetit Kontraktor, duhet të dërgoj një kopje të regjistrit të parashikimeve të prokurimit, si dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve në APP dhe në Drejtorinë e Buxhetit dhe Thesarit për prokurimet, sipas kërkesave të pikës “b” dhe “d” të nenit 3 të VKM-së nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, me ndryshimet.

- Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje duhet të kryej inventarizimin e brëndshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr.8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Menjëherë

- KVO të kryejë procedurën e vlerësimit të ofertave dhe të përpilojë procesverbalin për vlerësimin e tyre në bazë të kërkesave të VKM-së nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

- Për përmirësimin e punës duke marrë parasysh mungesën e specialistëve të fushës për prokurimet publike në DRSSH, të shikohet mundësia e kryerjes së procedurave tenderuese për blerje me vlera të vogla dhe të larta, të zhvillohen nga Sektori Prokurimeve pranë DP të ISSH-së, por kjo kërkesë duhet të shoqërohet nga institucioni me marrjen e masave për një programim sa më të drejtë të nevojave për mallra dhe shërbime.

Brënda vitit 2014

4. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dokumentimin e veprimeve të arkës dhe bankës, bazuar në konstatimet e auditimit kemi **rekomanduar:**

- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, të marrë masat e duhura që transaksionet e blerjeve apo shërbimeve të jenë të plotësuar me dokumentacionin përkatës justifikues në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ndërsa për riparimin e mjeteve pjesët që zëvendësohen të bëhen hyrje në magazinë.

- Të marrë masa që çdo pagesë e kryer nga arka të hartohet dhe të miratohet nga Nëpunësi zbatues, si dhe nëpunësi Autorizues sipas udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011.

Menjëherë

5. Nga auditimi u konstatua se për vitin 2013, nuk është kryer inventarizimi fizik i DRSSH, në kundërshtim të nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” sipas të cilit njësitë ekonomike duhet të kontrollojnë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse. **Për sa më sipër kemi rekomanduar:**

- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore çdo vit të kryejë inventarizimin e të gjithë pasurisë së institucionit, duke përfshirë dhe aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe për çdo rast të ngritjes së komisionit të inventarizimit, në përbërje të tij, nuk duhet të jenë personat që kanë konflikt interesi dhe se, punonjësi që ka në ngarkim apo, në përdorim aktivin, nuk duhet të marrin pjesë në komision por, ai, duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi.

Menjëherë

6. U konstatua se ky institucion nuk është pajisur me certifikatat e pronësisë për katin e tretë të Godinës si dhe të Agjencisë e Sigurimeve Shoqërore në rrugën “Myslym Shyri”, pronë e patundshme e këtij institucioni, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 620, datë 15.09.2006 dhe nenit 11 të Ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sipas të cilit se çdo kontratë apo dokument që ka efekt mbi të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme paraqitet për regjistrim jo më vonë se 30 ditë nga koha e realizimit të saj. **Për sa kemi rekomanduar:**

- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të marrë masa që, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të fillojë menjëherë procedurat përkatëse të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP.

Menjëherë

7. Në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe 65, dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitet 2012 dhe 2013, nuk ka hartuar dhe dërguar në ISSH, PBA dhe raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancë financiare, **rekomandojmë:**

- Nga Titullari i Institucionit të ngrihet një komision për hartimin e PBA, konform akteve ligjore në fuqi, si dhe të nisen raportet e monitorimit të buxhetit.

Menjëherë

8. Në rregulloren e brendshme të DRSSH Tiranë, nuk janë të përcaktuara qartë detyrat konkrete për çdo punonjës brenda degëve apo sektorëve të kësaj drejtorie, në lidhje me funksionet që ushtrojnë konform dispozitave ligjore. Në këtë rregullore, ka mospërputhje të përshkrimit të punës me emërtesat e vendit të punës, sipas strukturës së miratuar në funksionim, për sa kemi rekomanduar:

- Të merren masa për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit dhe përcaktimit të detyrave konkrete për çdo punonjës brenda Degëve apo Sektorëve në lidhje me detyrat dhe funksionet që ushtrojnë konform dispozitave ligjore dhe përshkrimeve të punës, në funksion të misionit për arritjen e objektivave të DRSSH-së Tiranë.

Menjëherë

9. Nga institucioni vlerësimi i performancës në punë të punonjësve nga eprori direkt, është bërë çdo vit, por, rritja në detyrë apo kategori, për rezultate të mira në punë nuk është bërë në mënyrë periodike shkallë pas shkalle dhe vit pas vitit sipas vlerësimit për punonjësit, por është bërë dy apo tre shkallë njëherazi çdo 2 apo 3 vjet dhe për disa nga punonjësit duke i diferencuar ato, sa sipër **rekomandojmë:**

- Çdo vit në përfundim të vlerësimit të detyrës dhe performancës në punë të bërë për çdo punonjës të DRSSH Tiranë, eprori direkt, në rastet e vlerësimit të punonjësit, të propozojë rritje në shkallën e ecuarisë dhe kalimin e punonjësit në një shkallë më të lartë, por jo më shumë se një shkallë në vit, duke zbatuar kështu rregulloren e personelit të ISSH-së dhe DRSSH-së.

Menjëherë

10. Për punonjësit e DRSSH-së, nuk është hapur dhe mbajtur libri i pagave (regjistri i pagave) duke mos aktualizuar kështu pagat dhe derdhjet e kontributeve çdo muaj për të gjithë punonjësit, në kundërshtim me ligjin 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, in dryshuar, neni 95 “Regjistri”. **Kemi rekomanduar:**

- Dega e financës dhe Dega e Administrimit të Përgjithshëm në DRSSH Tiranë, të marrin masa të menjëhershme për hapjen e Librit të pagave të punonjësve dhe të kryejnë hedhjen e pagave të punonjësve të DRSSH-së Tiranë me të gjithë elementet përbërës për periudhën e pa plotësuar e në vazhdim.

Menjëherë

11. Nga auditimi mbi pasqyrat financiare të DRSSH-së Tiranë, në fund të vitit 2013 paraqitet shuma 2,395,364,529 lekë, “debitorë për pensione”, që përfaqëson pensione pleqërie, pensione invaliditeti, pensione familjare etj., për përfitime të padrejta, për të cilat për arsye objektive dhe subjektive nuk ka nisur ndalesa. U konstatuan edhe raste të përfshirë në skemën e përfitimit, janë shpallur debitor dhe regjistruar në kontabilitet, por ngaqë nuk janë të hedhur në sistem nuk ju mbahen ndalesa si debitor. Po kështu, nga auditimi u konstatua se krahas debitorëve për përfitime të padrejta të regjistruar në kontabilitet, ka dhe debitorë të cilët janë evidentuar nga sistemi si të tillë, por nuk janë në kontabilitet dhe për pasojë nuk janë në listën e debitorëve të paraqitur në bilanc, **sa më sipër kemi rekomanduar:**

- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të koordinojë punën nëpërmjet Degës së Përfitimeve dhe Degës së Financës së DRSSH, për evidentimin dhe saktësimin e shumave debitorë, nëpërmjet kontrollit të dosjeve të përfitimit, pasqyrave debitorë dhe sistemin Online të pagesave.

Menjëherë

12. Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm rezultoi se, nga Titullari i institucionit, në kuptimin e implementimit të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 8/ç, nuk janë miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit, nuk është miratuar sistemi i rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrit të Financave, **kemi rekomanduar:**

- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore e Tiranës, Titullari i saj, të marrë masa për miratimin e rregullores për administrimin, financat dhe kontabilitetin, dhe ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, kërkesë e Ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

13. Nëpunësi Autorizues, nuk ka hartuar “Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. **Kemi rekomanduar:**

- Nëpunësi Autorizues të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar në afat tek titullari i njësisë publike “Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Pyetësonin e vetëvlerësimit”, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

14. Nga auditimi i vlerësimit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të bren dshëm rezultoi se:

- a. Në DRSSH Tiranë nuk është caktuar koordinatori i riskut, i cili në bazë të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, është funksion i Nëpunësi Autorizues, që në rastin e DRSSH-së Tiranë janë përcaktuar dy Nëpunës Autorizues, drejtori dhe zv/drejtori, të cilët nuk kanë ndarë apo deleguar disa nga detyrat dhe përgjegjësitë.
- b. Në DRSSH Tiranë, nuk është hartuar regjistri/strategjia e risqeve, duke mos zbatuar nenin 10 të ligjit të mësipërm.
- c. Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të bren dshëm rezultoi se rregullorja e bren dshme për funksionimin e njësive administrative në DRSSH Tiranë, nuk përmbush kërkesat e ligjit në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale, kompetencat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues dhe menaxherët e tjerë të njësisë.
- d. Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të bren dshëm ku rezultoi se DRSSH Tiranë, nuk ka të miratuar Rregulloren e Konfliktit të Interesave.

Për sa më sipër kemi rekomanduar:

- Titullari i DRSSH Tiranë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në zbatim të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 4/f dhe neni 9, pika 5, të ndajë dhe delegojë përgjegjësitë që lidhen me vendimarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.
- Titullari i DRSSH Tiranë, në cilësinë e Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatorit të riskut, të marrë masa për të hartuar regjistrin/strategjinë e risqeve në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke evidentuar risqet që pengojnë arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë njësi publike, si dhe veprimet për minimizimin e tyre.
- Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Tiranë të marrë masa që të reflektohen të gjitha ndryshimet e duhura në rregulloren e bren dshme të funksionimit të institucionit, në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale, kompetencat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues dhe menaxherëve të tjerë të Njësisë Publike.
- Titullari i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të hartojë dhe miratojë Rregulloren e Konfliktit të Interesave.

Menjëherë

15. Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave sipas komunave në DRSSH u konstatua se, nga 27 komuna vetëm 8 prej tyre kishin realizuar planin e të ardhurave, për të vetëpunësuarit në bujqësi. Nuk është realizuar numri i kontribuesve, të siguar si të vetëpunësuar në bujqësi, si rrjedhojë, të ardhurat për kontributet e “Bujkut privat”, duhet të ishin disa herë më të mëdha, pasi ky sigurim është i detyrueshëm në zbatim të neni 15 të ligjit nr.7932, datë 17.05.1995, të ndryshuar dhe ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga Inspektorët e bujkut, nuk ishte kryer në vazhdimësi komunikimi direkt me fermerët, si dhe nuk ishte bërë evidentimi i saktë i detyrimit për të paguar dhe ndjekur pagesat e prapambetura, e cila ka sjellë si pasojë që shuma e kontributeve të paguara përllëgaritet në rreth 40 milionë lekë (duke marrë parasysh kontributin mesatar vjetor të numrit të kontribuesve sipas bilancit të popullsisë dhe zbritur kontribuesit faktik). **Për sa më sipër kemi rekomanduar**

- Nga ana e DRSSH-së, në lidhje me komunat me mosrealizim nga, çdo inspektor i bujkut për të vetëpunësuarit në bujqësi, të merren masa për mbledhjen e detyrimeve në fillim të vitit dhe të njoftohen fermerët për të derdhur kontributet për të gjithë personat që janë aktivë për të derdhur sigurimin vullnetar dhe nxitjen e personave që janë në emigrim.

- Nga inspektorët e bujkut, komunikimi me fermerët të bëhet qysh në fillim të vitit në mënyrë direkte dhe në vazhdimësi duke bërë shpërndarjen e "Njoftimeve për pagesat e kontributeve" si dhe të bëhet evidentimi i saktë i detyrimit për të paguar dhe ndjekja e pagesave të prapam betura.

- Duke qenë se, këto probleme janë përsëritur në disa vite, duhet që nga DRSSH dhe çdo inspektor të ribëhet bilanci i popullsisë, të evidentohen me emra personat që zhvillojnë aktivitet bujqësor dhe që duhet të derdhen kontributet e detyrueshme, mbi bazën e tyre të bëhet plani i të ardhurave dhe të zbatohen të gjithë procedurat e mbledhjes, duke zbatuar dispozitat e parashikuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit të sipërshënuar.

Menjëherë

16. Nisur nga auditimi mbi kalimin e gjendjes së debitorëve në organet tatimore u konstatua se: Gjashtë subjekte që janë firma private, vazhdojnë të mbeten debitorë në DRSSH Tiranë dhe të pa kaluar për arkëtimin e kontributeve në organet e tatim taksave, që përpara vitit 2006, shoqëri të cilat kishin pezulluar aktivitetin dhe nuk kishin paraqitur listë pagesa për këtë detyrim duke mos evidentuar kontribues individuale.

U konstatua tendencë në rritje të subjekteve dhe detyrimeve të tyre të prapambetura në shuma të konsiderueshme, në organet tatimore, si tek subjektet e biznesit të madh ashtu dhe tek subjektet e biznesit të vogël, të cilat rrisin subvencionimin e ISSH, nga buxheti i shtetit. Ndërkohë që, pas këtyre detyrimeve janë një numër i konsiderueshëm kontribuesish të pasiguruar, të cilët mbartin një problem të madh social, në fushën e sigurimeve shoqërore, sepse nga mospagesat e kontributeve, këta persona nuk mund të jenë subjekt i ligjit të sigurimeve shoqërore dhe si të tillë nuk mund të trajtohen me asnjë lloj përfitimi.

Mosrealizim të numrit të kontribuesve kundrejt numrit të programuar të kontribuesve, numri i ulët i kontribuesve për një subjekt, numri i ulët i punonjësve me pagë minimale të cilat kanë sjellë një nivel të lartë të evazionit fiskal, me pasojë krijimin e një deficiti të konsiderueshëm në skemën e sigurimeve shoqërore.

Nuk janë dërguar listë pagesat për vitin 2013 dhe se aktualisht ky problem nuk ka marrë zgjidhje ndërmjet dy institucioneve qendrore duke bërë që të ketë mungesa të shumta të listëpagesave mujore në format letër përfshi edhe mungesat e listëpagesave mujore, format elektronik, të vitit 2013, sa sipër trajtuar në faqen 64-68 të Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për sa më sipër kemi rekomanduar:

- Të bëhet verifikimi përfundimtar i detyrimit dhe sistemi i tyre konform kërkesave të ligjit duke mbajtur parasysh interesat e personave të punësuar.

- Spas dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore dhe marrëveshjeve të përbashkëta, të realizohen rakordime të përmuajshme të gjendjes së debitorëve dhe lëvizjes së tyre, duke evidentuar dhe njoftimet dhe masat për evidentimin e tyre në çdo subjekt.

- Marrjen e masave të menjëhershme nga ISSH, DPT, ISKSH, MMS dhe Rinisë dhe MF për disa rregullime të akteve ligjore dhe nënligjore si: një udhëzimi të ri duke shfuqizuar ligjin aktual të MF nr. 26, datë 16.04.2009, një marrëveshje të re të përbashkët ndërmjet ISSH, DPT duke shfuqizuar marrëveshjen e përbashkët aktuale nr. 4620/2 dhe nr.18534/4, datë 10.11.2011, "Për dërgimin nga drejtoritë rajonale tatimore në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore të të dhënave për kontributet nga çdo subjekt".

- Hartimi e një marrëveshje të re të përbashkët ndërmjet ISSH, DPT "Për transferimin në format elektronik të listëpagesave mujore të subjekteve, të të dhënave për kontributet e paguara për çdo subjekt, të përmbledhësës të listëpagesave, për raportet dhe detyrimet për kontributet e prapambetura mujore dhe progresive të papaguara për çdo subjekt, si dhe për shkëmbimin e informacionit nga DPT në ISSH.

-Evidentimin dhe rakordimin e listëpagesave për subjektet buxhetor dhe jo buxhetor, biznesi madh dhe i vogël me procesverbal dorëzimi në arkiv.

Menjëherë

17. Për marrjen e ambienteve me qira të DRSSH -së rezultoi se: Në dosje nuk u gjend asnjë dokument që të vërtetonte se ishte testuar tregumbi çmimet apo tu referohehin publikimeve të ndryshme, por çmimet ishin vendosur vetëm midis palëve, pa bërë asnjë lloj negociimi. Nuk u gjend asnjë dokumentacion në të cilin të argumentohej arsyeja e marrjes me qira të këtyre ambienteve dhe afati mbi të cilën duhej të vazhdonte qiraja, por ky afat lihej i hapur, kemi rekomanduar:

- DRSSH, për çdo shërbim të argumentojë arsyen si dhe të ngrejë grup pune për testimin e tregut sipas kërkesave dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

18. Nga auditimi mbi zbatimin për shpenzimet e kryera për përfitimet afatshkurtra në DRSSH Tiranë, mbi barrë lindje të vetëpunësuarave në bujqësi, për vitet 2012 dhe 2013, rezultoi se ka diferenca ndërmjet masës kontributive dhe asaj përfituese, konkretisht për rastet e audituara, përfitueset kanë kontribuar mesatarisht vetëm 42,8 të vlerës së përfituar. Kjo periudhë e përfitimit të të ardhurave nga barrë lindja, është gjithashtu dhe vjetërsi në punë, sa kemi rekomanduar:

- Për pagesën e raporteve të barrë lindjeve, duke parë diferencat midis të ardhurave kontributive dhe shpenzimeve, të analizohet në mënyrë të holleshme dhe në bashkëpunim me ISSH-në të hartohen ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore për oportunitetin e kostove të përfitimeve për këtë sigurimit shoqëror.

Menjëherë

19. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve nga 23 rekomandime, masa organizative të rekomanduara, 2(dy) janë pa zbatuar, 1(një) është në proces, sa sipër trajtuar në faqen 9-18 të raportit Përfundimtar të auditimit. **Për sa më sipër kemi rekomanduar:**

- Në zbatim të shkresës nr. 162/7 datë 30.06.2012, të KLSH-së dhe Urdhrit nr. 70, datë 18.04.2006 të Kryeministrit "Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit atë Ministrive", DRSSH Tiranë, të vazhdojnë procedurat për zbatimin plotësisht të rekomandimeve të KLSH-së.

Menjëherë

B.MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Për Kodin e Punës", me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të kryhen kontabilitizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, në shumën **358,492 lekë** (blerje me vlera të vogla) punonjësve të DRSSH-së Tiranë, z. [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, znj. [REDAKTUAR] anëtare komisioni, znj. [REDAKTUAR] anëtare komisioni dhe znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e përgjegjëses së Financës.

Menjëherë

2. Të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i shumave prej **226,365 lekë**, paguar nga DRSSH Tiranë për punonjësit me kontratë individuale me kohë të pjesshme për ruajtjen e objektit.

Menjëherë

3. Të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i shumave prej **1,078,588 lekë** për llogari të DRSSH nga pagesa e pajustificuar për qiramarrje.

Menjëherë

4. Të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **2,157,176** lekë, pagesë qiraje e pajustificuar për shtyrjen prej 2 muaj të qirasë.

Menjëherë

5. Të ndiqen rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në shumën prej **1,168,560** lekë, *përfitur në mënyrë të padrejtë nga operatori ekonomik [redacted] shpk*, aplikuar për tvsh mbi pajisjet e DRSSH

Menjëherë

6. Për rastet e dublimeve të pensioneve, të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit të konstatuar në shumën **1,389,562** lekë dhe të përfitur padrejtësisht nga përfituesit e pensioneve, *duke paraqitur për lidhjet e pensioneve të tyre certifikata fallco*. Sipas përcaktimeve në nenin 62 pika 3, të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993, të bëhen ndalesa në masën 50% të kështit mujor të përfitimit të pensionit.

Menjëherë

C.MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, për shkelje të nenit 7, si dhe të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, t’i propozohet Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, pranë Bashkisë Tiranë, të vendosë gjobë për subjektin:

1. Shoqëria [redacted] sh.p.k me përfaqësues z. [redacted], në masën 200,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “Rikonstruksioni i Godinës së DRSSH-së”, pasi është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 1,048,644 lekë shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit faqe 53-56.

D.MASA DISIPLINORE

Për të metat dhe mangësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë ngarkuar me përgjegjësi ish punonjës të këtij institucioni, për të cilët Grupi i Auditimit nuk rekomandon masa disiplinore pasi gjykon se, këto masa janë ezauruar me evadimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të ushtruar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të ISSH-së. Drejtorja e Përgjithshëm i ISSH-së ka larguar nga detyra, 2 punonjës Znj. [redacted] Znj. [redacted].

Ndërsa: për Znj. [redacted] është marrë masa “Vërejtje me shkrim”.

Znj. [redacted] me detyrë ish drejtoresh e DRSSH ti jepet masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” sipas Rregullores nr 3/2 ,datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSHTiranë”.

Shënim: Për z. [redacted], ish drejtor i DRSSH-së Tiranë, nuk mund të propozojmë masë disiplinore pasi ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me Institucionin, me datën 03.01.2013.

E. KALLËZIM PENAL

KLSH, ka bërë kallëzim penal me Nr.524/8 datë 15.09.2014 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 6 persona, për konsumimin e elementeve të veprave penale “mashtim” dhe “falsifikim i dokumentave”, Neni 143 dhe Neni 186 i Kodit Penal. Këta individë, duke paraqitur të dhëna të parregullta të datëlindjes dhe çertifikata false, kanë përfituar padrejtësisht pensione në total **1,389,562 lekë,**